



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:1021/26 Datë: 29.06.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregullores (AKA) nr. 02/2025 për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 151 të mbajtur më 16.06.2026, mori:

V E N D I M

I. Nuk akreditohet programi i studimit i Kolegjit AAB:

- *Produksion dhe Performancë Muzikore BA, 180 ECTS (A)*

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji AAB brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik/bartësit si në tabelë:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	<i>Produksion dhe Performancë Muzikore BA, 180 ECTS (A)</i>	<i>Astrit Stafaj Driton Bejta Entela Demi</i>

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin AAB.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit). Ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; Produksion dhe Performancë Muzikore BA, 180 ECTS (A), vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 03.12.2025.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ko program ka këtë nivel të përmbushjes:

- *Plotësisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit;*
- *Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit;*
- *Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit dhe*
- *Nuk i përmbush Dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.*

Për shkak se ky program ka shumicën e fushave të standardeve të përmbushura vetëm Pjesërisht, nga ekipi i ekspertëve është vlerësuar se nuk i përmbush kriteret për akreditim dhe ekipi në raport përfundimtarë kanë dhënë rekomandimin se ky program **nuk akreditohet**.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 151-të, të mbajtur më datë 16.06.2026, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit AAB dhe duke u bazuar në raportet e ekipit të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit pas realizimit të vizitave si dhe rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtare të vlerësimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit AAB;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë